



In medias res

Planifikimi, Thembër e Akilit e ndryshimeve në arsimin e Kosovës

*“Shkurtimisht, detyra e cila arsyeton ekzistimin të gjithë prijesve është e lidhur për jo-stabilitetin, jo-normalitetin, ndryshimet dhe parregullsinë
Stejsi, 1996*

Koha post-moderne që nga themeluesit e Teorisë së Ndryshimeve në arsim: Peter Senge, Majkël Fullan, Oakes, Slee, Weiner, Tomlinson etj. quhet edhe kohe e Kaosit, sepse ndryshimet ndodhin në cepin e kaosit. Sipas këtyre autorëve ndryshimet që duken dhe janë racionale kanë pak apo fare nuk kanë gjasa të realizohen sepse e deri sa ne i projektojmë ndryshimet, ato kanë ndodhur, ndërsa ajo që ne kemi menduar të ndryshojmë nuk përputhet me atë që kemi menduar të ndryshojmë, meqë ajo që kemi menduar ta ndryshojmë tani ka ndryshuar. Në këtë kohë të kaosit duhet të depërtojmë në thellësinë e ndryshimeve për të kuptuar esencën e tyre dhe për të gjetur dhe identifikuar forcat e ndryshimit.

Depërtimi në thellësinë e ndryshimeve dhe identifikimi i forcave – agjentëve të ndryshimit na mundësojnë që të bëjmë planifikime të sofistikuara, subtile dhe të balancuara që duhet të jenë në pajtim ndërmjet tepricës dhe mungesës së strukturës, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me sisteme “vet-organizuese që zhvillojnë një sjellje të ndërlikuar dhe adaptibile.

“ Nëse struktura është tepër e fortë ajo do të jetë së tepërmi e ngurtë që të mund të ndryshojë. Po nëse struktura është më labile se sa duhet, ajo në mënyrë kaotike do të do të shpërndalet në të gjitha anët”(Braun, Ajzenhard, 1998).

“Që njeriu të kuptojë çka do të thotë të mbijetojë në cepin e kaosit, kjo asesi nuk do të thotë pranim i anarkisë. Sistemet e vërteta kaotike nuk kanë drejtime të caktuara të lëvizjes, nuk kanë përgjegjësi të ndara, vuajnë nga komunikim hamendësues, vetëm deri në një masë qëllimshëm eksperimentojnë dhe kështu vetvetiu ata nuk mësojnë Për dallim nga kjo, cepi i kaosit posedon dhe strukturën dhe hapjen.

Në elemente të strukturës bëjnë pjesë qeverisja drejt drejtimeve që ofron qëllimi, një numër i vogël i prioriteteve të rëndësishme, fokusi në dije dhe të dhëna që burojnë nga zgjidhja e përbashkët e problemeve, të dhënave dhe parashikimet të rezultateve...”(Fullan, 2005)

(vazhdon)

Shkroi: Halim Hyseni

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit shkurt është bërë monitorimi i 120 mësimdhënësve të Prishtinës, Ferizajit, Gjilanit dhe Pejës të cilat janë duke vijuar programin e MKLSH-së. Anët pozitive të orëve të monitoruara si dhe këshillat për përmirësim u diskutuan më datën 27 shkurt 2010. Përshtypja e përgjithshme e trajnerëve ishte se mësimdhënësit kanë filluar të zbatojnë teknikat në punën e tyre me nxënës.

■ Më 24-25 shkurt 2010 është mbajtur seminari i katërt dhe i fundit për 25 drejtorë të shkollave të komunës së Prishtinës dhe Obiliqit. Gjatë këtyre 2 ditëve trajnerët kanë paraqitur para drejtorëve përmbajtjet e udhëzuesve 6 dhe 8 të programit të MKLSH-së. Në fund të trajnimit, drejtorët u certifikuan për pjesëmarrje. Trajnimi i drejtorëve kishte për qëllim aftësimin e tyre për të realizuar me sukses monitorimin e mësimdhënësve në klasa.

Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës

■ Gjatë muajit shkurt janë bërë përgatitje me monitorues për të intervistuar zyrtarët komunal që kanë të bëjnë me financat komunale të arsimit në komunat Prishtinë, Vushtrri, Gjakovë, Istog dhe Gjilan. Intervistimi i këtyre zyrtarëve do të bëhet në mars dhe paraqet një ndër aktivitetet e projektit "Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës", të cilin është duke e realizuar KEC në bashkëpunim me KFOS.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Edhe pse zyrtarisht ky pilot-projekt ka përfunduar, gjatë këtij muaji është organizuar një vizitë nëpër disa shkolla të Komunës së Pejës, me qëllim të evidentimit të ndryshimeve që ka sjellë implementimi i projektit. Kjo do të kontribuoj edhe më shumë mundësisë së vazhdimit të këtij projekti edhe në komunat tjera.

Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit shkurt janë zhvilluar disa trajnime për shkollat fillore. Në Pejë janë mbajtur dy trajnime për klasën e dytë, Grupi i parë më 6, 7, 13 shkurt dhe Grupi i dytë më 20, 21, 27, shkurt.

Gjatë muajit mars pjesëmarrësit e dy grupeve do të prezantojnë planifikime javore, pas së cilave pritet edhe të certifikohen.

■ Në Prishtinë po ashtu u mbajt trajnimi për klasën e dytë me datat 12, 13, 14 shkurt. Pjesëmarrësin në këtë trajnim, prezantimin e planifikimeve javore do ta bëjnë me datën 03 mars si kusht për certifikim.

■ Në Ferizaj me datat 13, 14, 15, u mbajt trajnimi për klasën e dytë. Prezantimet do të mbahen me 13 mars.

KOSOVISION Contest

■ Këtë muaj mësimdhënësit fitues kanë nënshkruar marrëveshjet e tyre për vazhdimin e punës dhe kanë filluar përgatitjet e para të projekteve.

■ Tri klasat fituese me short të rastësishëm kanë kaluar tri ditë në

Brezovicë. Klasat fituese ishin V4 me mësuesen Remzije Baraku nga shkolla "Naim Frashëri", Prishtinë, klasa V me mësues Skender Paqarizi nga shkolla "Ruzhdi Xhyliqi", Marali-Malishevë dhe klasa V1 me mësuesen Mehrije Buleshkaj-Haxhijaj nga shkolla "Trepça", Banjë e Pejës.



Atje u organizuan aktivitete të shumta për nxënësit. I tërë qëndrimi në Brezovicë është përcjellur nga televizioni dhe që mund të shikohet më 6 Mars 2010.



Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Komisioni Evropian, janë organizuar

aktivitetet sipas projektit. Fillimisht është mbajtur takimi me këshillin drejtues të projektit ku është diskutuar për arritjet e deritashme në projekt, pra aktivitetet e bëra gjatë vitit të parë të projektit.

Po ashtu në këtë takim u diskutua edhe mundësinë e angazhimit të fëmijëve në disa aktivitete të cilat bëhen nga MASHT.

■ Është mbajtur një takim me trajnerët të cilët do të mbajnë trajnimet me nxënës. Në këtë takim u caktuan datat e trajnimit dhe u diskutua agjenda e punës dhe materiali i cili do të përdoret për trajnim. Trajnimet do të fillojnë nga data 6 mars 2010.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Më 10 shkurt u mbajt një takim me palët me interes të cilëve iu prezantua raporti kombëtar në kuadër të komponentës 2 të Projektit "Hulumtimet Kombëtare".



Në takim morën pjesë zyrtarë nga Departamentet e Arsimit të disa Komunave të Kosovës, zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, drejtor shkollash, nxënës, prindër, përfaqësues të OJQ-ve, etj. Takimi ishte mjaft frytdhënës, ku edhe pati diskutim të gjallë për raportin në fjalë. Në fund u morën rekomandimet të cilat janë inkomporuar në raport.



■ Sa i përket komponentës 3 të projektit “Praktikat më të mira” gjatë muajit shkurt janë kontaktuar shkollat dhe palët me interes që të ketë paraqitje të mjaftueshme të praktikave të mira.

Prevention on Peer Violence

■ Të gjitha aktivitetet e parapara me këtë projekt kanë përfunduar. Ky muaj ka qenë muaji kur janë mbledhur të gjitha të dhënat nga aktivitetet e bëra në projekt. Janë mbajtur edhe disa takime me psikologët dhe Fondacionin Together nga Kosova për të parë mundësinë e vazhdimit të këtij projekti. Raporti i është dorëzuar donatorëve në fund të muajit shkurt.

Access Microscholarship Program

■ Orët e Access janë mbajtur rregullisht për të dy grupet e Prishtinës gjatë muajit shkurt. Më 26 shkurt është mbajtur një aktivitet social për nder ditëlindjes së George Washington. Aktiviteti është mbajtur në restorantin Rings, ku aktivitetet e ndryshme janë shoqëruar edhe me një darkë të begatë.

■ Fatkeqësisht orët e Access për grupin e Prizrenit do të ndërpriten, për shkak të mungesës së profesorit amerikan.

Edukimi për Drejtësinë Shoqërore

■ Gjatë muajit shkurt është punuar në finalizimin dhe dokumentimin e këtij projekti. Në bazë të raportit që është dërguar tek donatori, pra te Ambasada e Amerikës në Kosovë, shihet fare mirë që projekti ka pasur një impakt shumë pozitiv në shpërndarjen e idesë së drejtësisë shoqërore dhe aftësimin e mësimeve, zyrtarëve dhe studentëve të Fakultetit të Edukimit, për zgjidhjen e padhunshme të konflikteve.

Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë

■ Gjatë muajit shkurt janë analizuar në mënyrë të detajuar të gjithë pyetësorët. Puna është kryer nga ekipi i KEC dhe Fakulteti i Edukimit. Futja e të dhënave është bërë përmes programit SPSS. Partnerët nga FE patën rast të shohin nga afër punën me këtë program, dhe gjatë punës, patën mundësinë edhe të mësojnë për mënyrën e shfrytëzimit të këtij programi.

■ Nga të dhënat është hartuar një raport edhe me disa rekomandime dhe është dërguar tek partneret zviceranë. Pas konsultimeve që do të kemi me partneret, do të bëjmë finalizimin e pyetësorit me komentet dhe sugjerimet, si dhe draftimin e projekt propozimit, për një projekt më gjithëpërfshirës në këtë fushë.

Projekti i përbashkët i historisë së Evropës Juglindore (JHP)

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë datave 6-7 është mbajtur trajnimi për trajnerë.

Trajnimi u shpall e hapur me fjalët përshëndetëse nga përfaqësuesit e KEC, CDRSEE dhe nga donatorët.



“Me anë të këtyre trajnimeve po kontribuohet në pasurimin me njohuri të mësuesve të historisë në shfrytëzimin e metodologjive të reja të mësimdhënësve dhe në shfrytëzimin e burimeve alternative” tha Petrit Tahiri, Koordinator i Projektit nga Qendra për Arsim e Kosovës.



Në këtë trajnim ishin të pranishëm 10 trajner (historian) nga Kosova. Ata gjatë 2 ditëve u njoftuan me Udhëzuesin e hartuar, si dhe patën rastin të shohin disa

prezantime për mënyrën e shfrytëzimit të këtij udhëzuesi. Trajnerët ndërkombëtar ishin: Inez Sutton nga Britania e Madhe (bashkautorë e Udhëzuesit) dhe Bozo Repe, Profesor i Historisë nga Sllovenia. Në prezantimet e tyre, trajnerët gjithashtu sollën përvoja të reja nga shtetet e tyre.

Trajnimi shkoi në frymë shumë pozitive dhe u çmua nga historianet e Kosovës që ishin të pranishëm.

Ky ishte aktiviteti i parë në këtë projekt. Parashihet që trajnerët nga Kosova të kenë mundësinë e shpalosjes së këtyre njohurive në trajnimet regjionale që do të organizohen.

■ Me datat 27-28 shkurt u mbajt trajnimi në Mitrovicë. Edhe pse ishin të ftuar 25 pjesëmarrës, aty morën pjesë 33 pjesëmarrës, të gjithë mësimdhënës të historisë nga rajoni i Mitrovicës.



Trajnim shkoi shumë mirë, pjesëmarrësit u ndanë të kënaqur me përmbajtjen e trajnimit, dhe u shprehën të gatshëm që Librat e shfrytëzuar në këtë trajnim do t'i shfrytëzojnë gjatë mësimdhënies.

Përgatiti: Petrit Tahiri